



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Raport për rezultatet e konsultimit publik për projektvendimin

“Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale”.

1. Titulli i projekt vendimit

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale” i është nënshtruar procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP), nga data 19.6.2025 deri me datë 17.7.2025.

Hartimi i këtij projektvendimi nga struktura përgjegjëse për pyjet në Ministri ka filluar rreth 2 vite më parë dhe për këtë janë marrë edhe mendimet e strukturave përgjegjëse për pyjet në disa bashki të vendit (Elbasan, Tiranë, Librazhd, Korçë, Pukë, Pogradec, shkodër, etj).

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të projektvendimit, ishin:

1. Publikimi në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP);
2. Konsultime të zhvilluara me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve;
3. Konsultim me Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, e cila në Këshillin Konsultativ Qeveri Qendrore-Vetëqeverisje Vendore, në mbledhjen e datës 21.7.2025 ka shprehur dakordësinë dhe s'ka paraqitur komente.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesit të përfshira janë bashkitë e vendit të përfaqësuara nga Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” nuk ka pasur komente. Numri i shikimeve të këtij projektvendimi në RENJKP është 212.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuar	Vendimi	Justifikimi